



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Kuvendi i Komunës
Nr. 001/011 - 151375
Datë: 13 nëntor 2024

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Ne bazë të nenit 12 paragrafit 2 shkronja c), nenit 40 paragrafit 2 shkronja a) dhe h), të Ligjit Nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/15, qershor 2008) nenit 10, nenit 25 paragrafit 1 shkronja a) dhe n), nenit 27 paragrafi 1, të Statutit të Komunës së Prizrenit me Nr.01/011-5643 i dt.15.10.2008, pas shqyrtimit të propozimit, Kuvendi i Komunës së Prizrenit në mbledhjen e mbajtur më 13 nëntor 2024, miratoi këtë:

RREGULLORE
PËR DHËNIEN E DEKORATAVE NGA KOMUNA E PRIZRENIT

Prizren, 2024

KREU I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është rregullimi i dhënies dhe revokimit të dekoratave nga Komuna e Prizrenit, për qytetarët e Republikës së Kosovës, personat juridik, qytetarët e huaj dhe organizatat e ndryshme që shquhen për merita të veçanta ndaj Republikës së Kosovës, Komunës së Prizrenit dhe interesave të saj.

Neni 2 Fushëveprimi

Fushëveprimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i llojeve, kritereve dhe procedurave për dhënien dhe revokimin e dekoratave, nga Komuna e Prizrenit, si dhe të drejtat dhe obligimet e të dekoruarve;

Neni 3 Përkufizimet

Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:

1. **Dekoratë** - nënkupton: titujt, çmimet, mirënjohjet dhe falënderime që i ndanë Komuna e Prizrenit.
2. **Revokim i Dekorates** - nënkupton: heqjen e së drejtës për bartjen e dekoratës së dhënë nga Komuna e Prizrenit.

KREU II DEKORATAT

Neni 4 Dhënia e Dekorates

1. Dekoratat mund të iu jepen personaliteteve dhe personave juridik që shquhen për merita të veçanta ndaj Republikës së Kosovës, Komunës së Prizrenit dhe interesave të saj.
2. Dekoratat mund tu jepen qytetarëve edhe pas vdekjes (Post-Mortem)
3. Dekoratat mund tu jepen shtetasve të huaj, personaliteteve të njohura botërore dhe organizatave ndërkombëtare të cilat kanë dhënë kontribut për Republikën e Kosovës.
4. Dhënia e dekoratave mund të shoqërohet me një shpërblim financiar, të përcaktuara me këtë rregullore.

Neni 5

Llojet e Dekoratave

Llojet e dekoratave sipas kësaj rregulloreje janë:

1. Titulli “Qytetar Nderi”
2. Titulli “Nderi i Prizrenit”
3. Çmimi i Lirisë “Remzi Ademaj”
4. Çmimi për të Arriturat në Arsim “Xhevat Berisha”
5. Çmimi për të Arriturat në Shëndetësi “Dr Daut Mustafa”
6. Çmimi për Demokraci “Masar Shala”
7. Çmimi për Humanizëm “Nënë Tereza”
8. Çmimi për të Arriturat në Kulturë dhe Art “Bekim Fehmiu”
9. Çmimi për Trashëgimi Kulturor “Edi Shukriu”
10. Çmimi për të Arriturat në Sport “Vrapuesja e Prizrenit”
11. Çmimi për Inovacion dhe Teknologji
12. Çmimi Vjetor për Zyrtarin Publik të Dalluar
13. Çmimi Vjetor për Qytetari Aktive
14. Çmimi për Gratë në Udhëheqje “Leze Qena”
15. Çmimi “Ndërmarrësi i Vitit”
16. Çmimi për Shërbim në Komunitet
17. Çmimi për të Arritura në fusha të ndryshme
18. Mirënjohjet dhe Falënderimet

Neni 6

Titulli “Qytetar Nderi”

Iu ndahet personaliteteve të shquara vendore dhe ndërkombëtare që nuk janë banor të Komunës së Prizrenit, të cilët kanë merita të larta dhe kontribut të jashtëzakonshëm për promovimin vendor dhe ndërkombëtar të shtetit të Kosovës, vlerave të identitetit, kulturës dhe trashëgimisë së vendit tonë dhe Prizrenit.

Neni 7

Titulli “Nderi i Prizrenit”

Iu ndahet personaliteteve të dalluara të Komunës së Prizrenit, të cilët kanë arritje të shquara dhe suksese të jashtëzakonshme në fushën e kulturës, arsimit, sportit, të drejtave të njeriut dhe fushave tjera relevante, të cilat sjellin krenari për qytetin dhe që me vete bartin trashëgiminë dhe vlerat e diversitetit social dhe kulturor të Prizrenit.

Neni 8

Çmimi i Lirisë “Remzi Ademaj”

Iu ndahet individëve dhe organizatave që përmbushin një sërë kriteresh të përgjithshme dhe të veçanta që reflektojnë përkushtimin e tyre ndaj vlerave të lirisë, drejtësisë dhe mbrojtjes. Ai duhet të demonstrojë një angazhim të fortë dhe të vazhdueshëm në promovimin dhe mbrojtjen e vlerave të luftës çlirimtare, të lirisë dhe pavarësisë së vendit gjatë kryerjes së një shërbimi brenda ose jashtë vendit. Çmimi mund t’i ndahet edhe individëve pas vdekjes për të arritura kulmore në fushat e sipërpërmendura.